



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 117, Korrik 2013
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

10 vjetori i themelimit të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini"

Bukuria dukagjinase nder breza



Mes miqve dhe anëtarëve që e nderojnë shoqatën



11 Shoqata "Dukagjini", në Miçigan, promovuese e vlerave të traditës

"SHEMBULLI I PARË DHE POZITIV QË NJË SHOQATË DINË TË RESPEKTOJ NJËRZIT QË PUNOJNË DHE KRYESORE TË RESPEKTOJNE NJERZIT E VET" "NDUE FTONI, NDERI I 100 VJETORIT"

8 ZINA FRANJA U NDA NGA JETA

Një sëmundje e rënde dhe e gjate, me datën 11 korrik 2013, i mori jetën, njëres nga luftëtarët më të paepura për emancipimin e shoqërisë dhe në veçanti të femrës shkodrane; njëres nga veteranet e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare; Anëtares së Nderit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", trimëreshës dukagjinase, të paharruarës Zina Frani (Plani), që akoma e donim ta kishim në mesin tone jo vetëm fizikisht, por mbi të gjitha për mendjen, për urtinë dhe arsyetimin e saj, vajza Geti, dhëndri Tonini, nipat Sokoli, Eugeni e Juliani dhe të afërmit e saj, komunitetit ku jetonte dhe ne, veteranet dhe anëtarët e shoqatës.



SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
NDUE FTONI



FJALA PREZANTUESE E PUNËS 10 VJEÇARE TË SHOQATËS "ATDHETARE-DUKAGJINI"

Të nderuar miq!

Të nderuar pjesëmarrës!

Zonja e zotërinj!

E ndjeje veten mire, që jam para jush, me rastin e këtij 10 vjetori. U bën 10 vjet pune e vetëm pune, pune e pa ndalur e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në themel të cilës ka pas vetëm dhe vetëm një çelës, i cili për shume kënd është dukur i pabesueshëm, por ky çelës ka qene "vullnetarizmi!" Prandaj, vijmë në këtë dhjetë vjetor, vijmë para jush, para dukagjinave, para qytetarisë shkodrane, para miqve dhe bashkëpunëtorëve kolege, krenar për punën që kemi bere.

Në këtë feste marrin pjesë anëtar të shoqatës, Anëtar Nderi të saj, përfaqësues të shoqatave e organizatave bashkëpunues që nga Republika e Malit të Zi, në Kosove dhe deri në Kosovën Lindore, të famullisë Shkodër, pedagog të Universitetit të "Luigj Gurakuqi, të grupimit "Aleanca për Jetën", të ushtarakeve në rezerve dhe në pension, të veteraneve, të Klubit Shqiptar të Medies, përfaqësues të komunës së Pejës, të pushtetit vendor të qytetit Shkodër dhe të komunave të Dukagjinit, shkrimtare, poete, studiues, përfaqësues të medieve lokale, të tjerë e të tjerë, të cilëve, në emër të shoqatës, ju uroj mirëseardhjen, për të na nderuar në këtë feste të shoqatës, e cila nuk është feste vetëm e jona, por është feste edhe e Dukagjinit, edhe e qytetit tone.

Dhjetë vjet më pare, grupi i përberë nga Ndue Sanaj, Prele Shytani, Luigj Shyti, Mri Kroj, Ndue Vata, Pal Lera, Fran Kapaj, Fran Preçi, Martin Ara dhe Zef Nika, mori nismën të themelimit në një organizatë të komunitetit dukagjin, duke pasur në vëmendje të punës së tyre moton: "Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por çfarë unë bëra për Dukagjinin".

Misioni i Shoqatës ka qenë dhe është i thjeshtë: "Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të parëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërë më mire vendin që meriton në hapësirën e qytetëruar dhe moderne".

Këta themelues, nuk e patën të lehtë! Ju deshën kohe që takime pas takimesh të diskutonin për të bindur njeri-tjetrin, nëse, do të ishin në gjendje të arrinin për të ngritur në pedestalin e duhur traditat e të pareve tanë dhe ti bënim pjesë integrale në

vlerat e qytetarisë shkodrane e më gjere, nëse do të ishin në gjendje të mund të kapërcenin disa mendime jo të pakta të një shoqërie primitive, të një



Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj, duke prezantuar punën 10 vjeçare të saj

shoqërie pa shtet, ti bënin pjesë të tyre, ti mundnin e të triumfonin mbi to, duke vene në plan të pare vlerat tona më të mira, pjesë e vlerave trashëguese e të nevojshme për tu prezantuar denjësisht në shoqërinë e hapur, në themel të cilës janë vlerat e individit.

Me 15 dhjetor 2002 vendosen më në fund: PO!, do të themelohet shoqatën.

Me datën 26 janar 2003 mblodhëm një aktiv. Ky aktiv, vendosi të krijohet shoqata, i cili miratoi planin e programin e nismëtarëve, krijoj grupet e punës.

Me datën 6 prill 2003, u mblodhe konferenca e Pare, me 32 anëtar, e cila miratoi raportin themelues, Statutin, Programin dhe logun e shoqatës, zgjodhi kryesinë e Saj.

Statusi, person juridik u mor me datën 13 maj 2003. Me datën 7 qershor të atij viti, në sallën e Prefekturës të asaj kohe, beri prezantimin e themelimit të saj.

E bëra këtë paraqitje të shkurtër, për të treguar se, nuk ishte e lehtë për ta themeluar, për të formuar vizionin e qarte dhe për të punuar në realizimin e misionit të saj. Madje, na thane: "Nuk punohet me dukagjinat!", duke qene vete dukagjinat! "Nuk kemi mundur ne, ku mund të punoni ju!", "Disa thoshin se, kjo shoqate është komuniste, disa të tjerë thoshin se, kjo shoqate është balliste!"

U paragjykuam nga disa dukagjinat, nga disa shkodrane, duke na krijuar pengesa jo të pakta, të cilat jo në pak raste na kane lodhur, por nuk kane mundur të na ndalnin pa ecur, dhe tani jemi këtu, në këtë dhjetë vjetor para

jush me jo pak arritje.

E filluam shoqatën me 32 anëtar dhe sot jemi 232 anëtar, madje sot 19 prej tyre marrin për here të pare kartën e

anëtarësisë. Anëtarësia e shoqatës është e shtrire në 5 dege, në Tiranë, në Kurbin, në Lezhe, në Shkodër dhe në Malësi të Madhe. Në gjirin e saj ka "Anëtar Nderi", të cilët edhe sot janë e japin kontribute në shërbim të Atdheut dhe këta janë që nga Mjeshtri i madh Fadil Kraja e Ahmet Osja dhe deri te piktori i "Merituar" Zef Shoshi, që nga motra Sandra Bertolotto e deri te Ukshin Jashari-kryetari i Shoqatës së Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" në Kosove, që nga Pal Ndreshaj në Tuz, vellai i Martin Dreshajt, emrin e të cilit mban Shoqata e Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe, me qendër në Peje dhe deri te profesor Raxhep Abazi në Medvegj. Por kemi "Anëtar Nderi", të cilët nuk jetojnë, por me kontributin e tyre na kane frymëzuar për të punuar, si At' Luigj Marlekaj, Artisti i Popullit Lec Shllaku, këngëtar i Pllumb Tefa e deri te Mësuesi i Popullit Shefik Osmani.

Gjate këtyre viteve, me keqardhje ju njoftoj se, janë nda nga jeta disa anëtar shoqate: anëtarët e shoqatës Karlo Marlekaj, Marash Ndoja, Ndue Dede Bregu, Martin Çuni, Nik Pali, Nikoll Vocaj e Mark Lumaj, dhe Anëtari i Nderit, Artisti i Popullit Lec Shllaku. **Më lejoni, që në respekt të jetës e veprës së tyre, t'iu ftoj të ngrihem në këmbë dhe të mbajmë një minute heshtje! I përjetshëm qofte kujtimi i tyre!**

Më lejoni të bej një paraqitje të shkurtër të arritjeve në funksion të realizimit të misionit të shoqatës në këto 10 vite:

Dhjetë vjet hulumtime e studime, botime dhe publikime për vlerat dukagjinase, të cilat

kane qene pjese e jetës së tyre në shekuj në shërbim të vetëqeverisjes, të atdhetarizmit, të përkushtimit për të qene të lire e të pavarur në jetën e tyre, të cilat janë kurorëzuar me 6 simpoziume shkencore, me teme: "Kuvendet malësore dhe koha" kushtuar 85 vjetorit të Besës së Prekalit; me teme "Traditat atdhetare dhe liridashëse të dukagjinave në vitet 1890-1920" kushtuar 95 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit dhe 90 vjetorit të Luftës së Planit; "Një misionar në shërbim të Kombit", kushtuar 100 vjetorit të lindjes të një prej figurave të rëndësishme të nacionalitetit shqiptar, At' Jak Marlekaj, ose profesor Luigj Marlekaj; me teme "Kultura materiale e shpirtërore e dukagjinave"; me teme "Femra dukagjinase në kohe"; me teme "Gjakmarrja retorike apo realitet", në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe, kushtuar kësaj gjendje të rende të vrasjes nder veti të shqiptareve dhe shfrytëzimi i saj nga disa për të fituar e për të jetuar; në një konference përkujtimore, me teme: "Ndihmesa e kryengritjeve Antiosmane të malësoreve të Veriut për arrijtjen e Pavarësisë", në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në bashkëpunim me shoqatën "Martin Dreshaj" dhe "Integrimi Evropian" dhe në një seminar shkencore, me teme "Drejtimet e mundshme të zhvillimit të Dukagjinit", në kuadrin e përpjekjeve për zhvillimin e zonës dhe të banorëve të saj. Tre prej këtyre konferencave janë botuar në dy libra, me titull "Dukagjini në rrjedhat e historisë-1 e 2".

Menduam që në punën tone të kemi një avokat!? Avokatin e gjetëm, madje nga më të mirët, gazetën, e cila është e pagëzuar me emrin "Dukagjini", numrin e pare i së cilës u paraqit në media vizive dhe në publik me datën 30 dhjetor 2003. Atë e kemi prezantuar çdo muaj. Me 31 mars 2012, festuam nxjerrjen e numrit i 100 të saj dhe sot ju kemi të dhenë numrin 116 të kësaj gazete.

Kemi bere përpjekje të nxisim hulumtuesit, studiuesit e shkrimtarët të shkruajnë, dhe diçka ia kemi arrite qëllimit. Shume dukagjinat kane shkruar, shume dukagjinat kane botuar. Një pjese prej tyre ia kemi prezantuar publikut. Deri tani janë paraqite 56 libra të autoreve dukagjinat, që kane shkruar kryesisht dukagjinat për Du-

kagjinin. Ata janë të shumte, por kryesisht janë Ndue Cukeli, Prele Milani e Lazer Kodra, Ndoc Bjeshka, Shefqet Kelmendi, shkrimtari Lazer Stani, Mirash Mici, Artisti i Popullit Lec Shllaku, Voc Deda, prof. as. dr. Zef Gjeta, Lulash Brigja, Sokol Prela, Mjeshtri Fadil Kraja, Luigj Shyti, Mhill Pali, Pal Doçi e të tjerë, të cilëve ju themi: "Të mos ndalen, të vijojnë, të vijojnë e të vijojnë të shkruajnë se, ajo që hidhet në letër mbetet, të tjerat i merr era dhe mbesin në nivelin e legjendës, të cilat këto janë të bukura, por jo në pak raste po na lodhin".

Kemi bere përpjekje që nëpërmjet veprimtarive artistike të mbledhim e të publikojmë vlerat folklorike dukagjinase. Kemi realizuar 10 mbledhje argëtuese; është dhenë një koncert folklorik, të pagëzuar "Folk-2007" në Teatrin "Migjeni" dhe janë mbështetur edhe tre koncerte të tjera, çka ka dhënë mundësinë të prezantohet sa më denjësisht në mjedisin shkodrane folklori dukagjinat nëpërmjet interpretimit të këngëtareve dukagjinat, të cilët tashme janë të organizuar në ansamblin "Treva" e Dukagjinit.

Kemi bere përpjekje që nëpërmjet ekspozitave, si ekspozita e fotografisë nga Luigj Shyti dhe Luigj Mila dhe ekspozita e pikturës të pagëzuar "Peneli dukagjinat" me 18 piktore të moshave të ndryshme, me në krye Artistin e Merituar Zef Shoshi dhe Mjeshtrin Ndoc Gurashi, duke publikuar natyrën e bukur të hapësirës së Dukagjinit dhe vlerat artistike të dukagjinave në fushën e fotografisë dhe të pikturës.

Kemi bere përpjekje të mos mbesim në vetvete, të jemi të hapur. Kemi bere përpjekje të jemi prezent ku ka qene e mundur. Sot jemi anëtar themelues të organizatës së madieave lokale "Klubi Shqiptar i Medias"; në organizatën Grupi i Veprimit Lokal "Bjeshkët me Name" të ndihmuar nga djali i Thethit Mark Rupa; me organizatën e Gruas "Hapat e Lehte", me Universitetin "Luigj Gurakuqi"; me bibliotekën e qytetit "Marin Barleti", me Muzeun Historik në Shkodër, me Teatrin "Migjeni" e me teatrin "Iliricum", me Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tirane, me Këshillin e bashkës së qytetit tone; me Komisionin Drejtësi e Paqe me qendër në Shkodër; me Shoqatën kulturore "Spani"; me organizatat: "Ambasadoret e Paqes", Fondacioni "JO gjakmarrjes-Po

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" në 10-vjetorin e saj

OPINIONE

NDERIMI QË MË BËNI SOT, DUKE ME SHPALLUR: "ANËTAR NDERI" I SHOQATËS SUAJ, ME PREKE JASHTËZAKONISHT SHUME ...



Profesor doktor Mahir Hoti, duke përshëndetur, në 10 vjetorin e shoqatës

Ju falënderoj për ftesën e bere për këtë 10-vjetor të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini". Ndihem krenar që jetova e punova për disa vite në zonën tuaj të ashpër për nga relievi e klima, por me njerëz bujare e të dhanun për dije, që më deshën dhe i desha sinqerisht.

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", në 10-vjetorin e jetës së saj, me qendër në qytetin e Shkodrës e me dege në disa rrethe të tjera, ka kontribuar fuqishëm në ruajtjen e traditave më të mira të atij populli, si në evokimin e kujtesës historike të tij, ashtu dhe në bërjen

jehone të arritjeve më të mira në ditët e sotme. Në këtë rrugë ka meritën të ketë shërbyer veçanërisht gazeta "Dukagjini", me 116 numra deri tani, si tribune e promovimit të vlerave të gjithanshme natyrore dhe historiko-kulturore, po ashtu dhe të figurave më të shquara që ka nxjerre në vazhdimësi si dhe të personaliteteve që kane shërbyer atje në vite, si tregues i mirënjohjes dhe respektit. Me këtë rast nuk mund të rri pa vene në dukje faktin se, vazhdimësia e botimit të gazetës tuaj është dhe një model, sesi dhe një shoqate, kur ka vullnet, përkushtim dhe njerëz bujare e biznesmenë të motivuar, që mbështesin, mund të konkurrojnë me sukses dhe një qytet të tere.

Nderimi që më bëni sot, duke me shpallur: "Anëtar Nderi" i shoqatës suaj, me preke jashtëzakonisht shume, edhe pse gjate jetës e punës time jam nderuar me tituj e dekorime të ndryshme, si brenda dhe jashtë vendit. Kjo është diçka e veçante dhe e paharruar për mua. U jam vërtetë mirënjohës për vlerësimin dhe do të përpiqem të kontribuoj sado pak në ecurinë e mëtejshme e cilësore të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini". Me lejoni të shpreh një konsiderate të veçante për koleget dhe miqtë e mi Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Luigj Shyti, Prele Shtyri, Lazer Kodra, Prele Milani, e të tjerë, të cilët me sa kam ndjekur veprimtaritë e shumta e të larmishme të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", kane luajtur një rol tepër të madh në ecurinë e jetës dinamike të saj dhe në sensibilizimin e opinionit shkodran deri dhe përtej detit, ku jetojnë e punojnë dukagjinasi dhe jo vetëm ato.

Edhe njëherë, ju faleminderit dhe suksese të mëtejshme shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"!

DUKE BASHKËPUNUAR ME JU, JEMI SHUMË MË TË FORTË

I nderuari Ndue Sanaj!
E nderura Kryesi!

Të nderuar veprimtarë e përkrahës të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"!

Kam nderin që në emër të kryetarit të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", Ukshin Jashari, Kryesisë dhe gjithë veprimtarëve të Shoqa-



Rrahman Jashari, koordinatori i Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj"

tës sonë nga Kosova, Hoti, Gruda, Trieshi, Koja, Plava, Gucia, Rozhaja, Kosova Lindore dhe trojet tjera t'u përgëzojmë për angazhimet dhe për arritjet e mëdha që keni shënuar në këto dhjetë vite të punës suaj në shërbim të artit, kulturës dhe traditës dukagjinase dhe nacionale.

Ishte moment shumë me vlerë për ne, takim i parë vëllazëror dhe pastaj edhe veprimtaritë e përbashkëta në qytetin e bukur të Shkodrës dhe në qytetet e Kosovës.

Ju jeni shembull i shkëlqyer i punës dhe angazhimeve të përkushtuara në shërbim të kulturës dhe traditës sonë të pasur. Duke bashkëpunuar me Ju, jemi shumë më të fortë dhe bashkërisht kemi arritur të rrugëtojmë suksesshëm në përbushjen e misionit tonë të përbashkët.

Ju priftë e mbara dhe sukseset nëpër vite e dekada!

Gëzuar edhe një herë nga zemra këtë festë të madhe!

TË PARET ISHIN DUKAGJINASI QË MË AFRUAN ...



Kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër, av. Bardhyl Lohja

Me Dukagjinin e dukagjinasi më lidhin shume pjese të jetës sime!

Së pari, në vitin 1981, po sa isha kthyer nga internimi, më dërguan në pune, në Kombinatin e Drurit. Askush nuk më afro, përveçse dukagjinasi pa-



jetës", Operacionit Colombo-Papa Gjoni XXIII, "World Vision", Caritasi në Shkodër dhe Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike, dhe me këto të fundit jemi të grupuar në organizatën "Aleanca për Jetën" për kundër gjakmarrjes. Në veçanti, bashkëpunimi me i suksesshëm ka qene lidhja me Shoqatën e Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" me qendër në Peje. Me gjithë këtë bashkëpunim, jo vetëm na është krijuar mundësia të prezantohemi, por na është dhenë mundësia të shkëmbejmë eksperiencë në të mire të ecjes përpara për të realizuar misionin e shoqatës, e cila do të vijojë edhe në të ardhmen. Respekt dhe mirënjohje për punën që bëjnë dhe për ndihmën që na kane dhenë!

Me punën e bere dhe me ndihmën e strukturave të pushtetit vendor në Shkodër, të Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe të Presidencës, në këto 10 vjet kemi arrite të kemi në gjirin tone:

* Mehmet Shpendi i dekoruar me "Medaljen e Arte të Shqiponjës"

* Profesor Kole Prela "Qytetar Nderi" të qytetit Shkodër;

* Artistin e Popullit Pjeter Gjoka "Qytetar Nderi" i qytetit Shkodër,

* Pikturin Lin Delija "Nderi i Kombit";

* Albanologun Martin Camajt "Nderi i Kombit" dhe "Qytetar Nderi" i qytetit Shkodër,

* Gac Çuni "Qytetar Nderi" i qytetit Shkodër,

* Legjendën e futbollit, Dode Tahiri "Mirënjohja" e qytetit Shkodër.

*** Të gjitha këto arritje, nuk janë bere me frymën e shenjte. Ato kane pasur një kosto jo të pakte financiare. Financimi i veprimtarive të shoqatës është siguruar fale bujarisë të 105 dukagjinasi, në mes të cilëve më lejoni të veçoj Ndue Ftonin në SHBA, Konsullin e Nderit të Republikës së Austrisë, Gjergj Leqejzen në Shkoder, Komunën e Pultit, biznesmenin Mhill Prorin, Pal Gjollaj, Gjergj Vocaj, Pal Lera, Kompaninë e sigurime "SIGMA" dega Shkodër e të tjerë. Të gjithë, në emër të shoqatës i falënderoj për kontributin e tyre, për atdhedashurinë e tyre ndaj Dukagjinit e dukagjinasi! Paçin e dhënçin! Nga kjo foltore, ju bej thirrje të gjithë biznesmenëve dukagjinasi të mos trem-

ben, por të afrohen e të ndihmojnë financiarisht se, kontribuojnë për veten, për familjen, për vlerat e Dukagjinit dhe për brezin e ardhshëm dukagjinasi, për prezantimin tone në mjediset e kultures, në mjediset e shkences, në mjediset e shoqerise demoktarike, në mjediset e shoqerise së hapur, në themel së ciles jane vlerat e individit, dhe deri në strukturat e shtetit në vendimmarrje, me sa më shume denjitet.

*** Me këto arritje nuk kemi bere ndonjë shpikje shkencore, as nuk kemi hip në ndonjë lartësi që të tjerët nuk kane hipur më pare, por kemi bere punën tone modeste që duhet të bej çdo atdhetar. Kemi bere përpjekje që sot ta shikojmë veten nga një gjendje morale tjetër, dhe besojmë se ia kemi arrite qëllimit në nivel të kënaqshëm. E ndjejmë veten të kënaqur, në qoftë se sadopak të tjerët do ta shikojnë të mire këtë që kemi bere deri tani, dhe mbi bazën e së cilës do të bëjmë edhe në të ardhmen. Ne kemi bere përpjekje më shume të ecim sipas një thënie të Pablo Neruda "E qeshura është gjuha që flet shpirti". Kemi bere

përpjekje të qeshim, të gëzojmë dhe të shikojmë njeri-tjetrin mire, pavarësisht kundërshtive në të mire të punës, duke pasur parasysh se, kur qesh fytyra, qesh shpirti, dhe kur qesh shpirti ka mirëkuptim, ka dashuri në mes njeri-tjetrit, pa të cilin nuk mund të jetohet.

Në mbyllje, në emrin tuaj, më lejoni të falënderoj dhe t'iu shpreh mirënjohjen atyre që na bënë të mundur financimin, të festojmë sot së bashku: Familjin e Shën Shtjefni në Shkoder, Silvana e Ilir Arrinaj, Gjergj Leqejza, Mark Rupa, Ndue Mici, Ndue Ftoni, Gjon Shtyllëza, Luigj Mila, Gjergj Vocaj, Marjana Sinani dhe Ndoc Bleshka.

Dhe një here ju falënderoj për pjesëmarrjen, për kontributin që keni dhënë! Sigurisht besojmë se, ky kontribut do të jepet edhe në të ardhmen për të vijuar realizimin e misionit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"!

**Gëzuar Festen! Gëzuar 10 Vjetorin e themelimit të Shoqatës!
Ju faleminderit!**

varësisht bindjeve të tyre politike të kohës. Më afrian dhe më deshten si djalin e vëllan e tyre, të cilëve ju jam për jete mirënjohës.

Së dyti, vitaliteti i tyre. Ata kudo kane shkëlqyer! Në qofte se donë një artist të madh, në radhe të pare kërko dukagjinat! Në qofte se donë një shkrimtar të madh, në radhe të pare kërko një dukagjinat! Në qofte se donë një sportist të madh, në radhe të pare kërko një dukagjinat! Në qofte se donë një atdhetar të madh, në radhe të pare kërko një dukagjinat e në të tjera fusha në jetën e vendit dhe të shoqërisë shqiptare, në radhe te pare kërko dukagjinat.

Së treti, në këto vite të demokracisë nuk kemi pasur shoqate kaq aktive, nuk kemi pasur shoqate që të na ketë fut në pune sa shoqata e juaj. Prandaj u jemi mirënjohës për punën që bëni dhe ju urojme, të eci gjithnjë përpara në shërbim të komunitetit dukagjinat, në shërbim të komunitetit shkodrane, në shërbim të integritetit sa më denjësisht të dukagjinatve në shoqërinë demokratike.

Përgëzime, për punën që keni bere dhe kam besim se do të ecni pa u ndalur në realizimin e misionit tuaj, baze e së cilës është edhe kjo veprimtari mjaft e madhe, mjaft komplekse, mjaft e organizuar dhe mjaft e shkëlqyer. Ju lutem! Respekt!

TI JE E JONA ... TI JE NJËRA PREJ NESH ...



Prof. as. Dr. Marjana Sinani

U bëra dëshmitare dhe pjesë e festimit që kjo shoqatë zhvilloi në 10-vjetorin e saj. Isha e ftuar si e bija e Nik Palit, një dukagjinat në të gjitha përmasat intelektuale dhe i vlerave, një njeri i ndërgjegjshëm dhe krenar për origjinën e tij, një qytetar civil e thellësisht i angazhuar për të konservuar “kujtesën histo-

rike e kulturore” të Dukagjinit dhe dukagjinatve, një baba që diti si radhë kush ta përcjellë identitetin dukagjinat tek unë, bija e tij e madhe dhe gjithë fëmijët e tjerë deri tek nipat dhe mbesat e tij...

U thirra të merrja titullin e nderit që Shoqata kishte akorduar për babanë tim ... dhe më pritën si bijën e tyre, por më rikujtuan: “Ti je e jona ... Ti je njëra prej nesh” dhe Unë u ndjeva e tillë dhe e ri-konfirmova ...PO! ...

10-vjetori! Të festosh ... A duhet të dish të festosh!? PO!

Dukagjinatit dinë të festojnë, pasi ata dine të bëjnë rezymenë e asaj që janë e asaj që bëjnë, ata dine të projektojnë perspektivë, ata dinë të kenë memorie intelektuale, ata dinë të ndërtojnë aleanca, ata dinë të kenë miq dhe miqësi afatgjata, ata dinë të presin dhe të përcjellin kulturat e të tjerëve ... Ata dinë të ecin me të sotmen dhe të nesërmen. Ata dinë të jenë modestë dhe krenarë njëkohësisht. Këtë e konstatova tek takova dhe përcolla gjithë atmosferën që sollën në takim të ftuarit në dhjetëvjetorin e kësaj shoqate.

Takova dhe pashë miqtë që sollën miqësinë dhe respektin nga Peja, Tuzi, Rozhaja dhe Rrafshi i Dukagjinit, takova dhe e çmova fuqishëm Profesoratin e Universitetit “Luigi Gurakuqi” të Shkodrës, prania e të cilëve aty, më dëshmoi atë miqësi dhe vëmendje afatgjatë dhe shume domethënëse ... që historikisht mendimi elitar shkodran ka treguar për Dukagjinin dhe dukagjinat si “substance” kulturore dhe vlere e spikatur. Mendimi elitar shkodran e ka çmuar Dukagjinin dhe dukagjinatit jo vetëm si një potencial njerëzor me një mendim të sofistikuar, jo vetëm “objekt” me etnicitet kulturor original, shume interesant për tu hulumtuar, por dhe si njerëz që dinë të ofrojnë e të garantojnë miqësitë dhe mbështetje afatgjata.

Konstatova praninë e përfaqësuesit të këshillit bashkiak në dhjetëvjetorin e shoqatës, çka me më përcolli gjithë vëmendjen e strukturave lokale qeverisëse për këtë komunitet potencialisht kaq energjik, që po rritet intensivisht dhe aktivisht në qytetin e Shkodrës.

10-vjetori- shoqatës! Tek unë mbërriti si një histori suksesi ku ka shumëçka të thuash. Modestisht dhe përmbledhtazi, Ndue Sanaj, përmes një repertori sjellor tejet etik, kishte seleksionuar të listonte vetëm disa nga veprimtaritë që kishte kryer kjo shoqatë ... Sytë dhe fokusi i tij dhe i gjithë stafit nuk ishin veprimtaritë që ishin bërë por, çfarë pritet të bëjë kjo shoqatë. Dukshëm, binte në sy projekcioni për të nesërmen ... Anëtarësimi i të rinjve në shoqatë, ishte preokupimi ... Ky takim erdhi tek unë si i mirë-organizuar, i qëllimtë

në synimet e veta, shumë-përmasor, i strukturuar në programin e ditës së dhjetëvjetorit, përcolli tek unë, *urtinë* që vjen prej njerëzve që e duan vendin e vet ... *por ... dhe dinë ta duan origjinën e vet, vendin prej nga vijnë*. Të duash është një gjë ... por ... të dish të duash, është një tjetër gjë.

Unë u bëra dëshmitare se, pjesëtarët e këtij komunitet dinë ta çmojnë modestisht prejardhjen e vet dhe dinë të gjejnë veten në zhvillime dhe kontekste të reja. Isha me fat të ndaja plot një ditë feste, ku modestisht u dokumentua “historia” e asaj që ishte bërë ... me pjesëtarët e komunitetit tim dukagjinat. Përgjatë gjithë ditës, kisha plot “sy e veshe” të shihja e të dëgjoja ato që u artikulan dhe ato që modestisht nuk u thanë ... kisha mjaft instrumente të kuptoja gjithë çfarë ishte bërë dhe gjithë çfarë ky komunitet dëshironte të bënte. Ajo që dukshëm dhe fuqishëm unë e ri-konfirmova ishte se, preokupimi i kësaj shoqate ishte tejet i lexueshëm:

Identiteti.

Kujtesa historike. Gjithçka që Dukagjini ka prodhuar, kontribuar dhe vazhdon të prodhojë dhe të shfaqë.

Kohezioni.

Kohezioni mes të djeshmes - të sotmes - projeksonit për të nesërmen. Kohezioni mes brezave, kohezioni me veten. Dukagjinatit din shumë mire, ti japë përgjigje pyetjes “Kush jam unë?”

Struktura.

Anëtarët e shoqatës dukshëm funksiononin si një ekip, të preokupuar seriozisht të zhvillojnë substancën e vet në kontekstet e reja sociale. Tek unë mbërriti ideja se shoqata i kishte kaluar formatet e shoqatës. U ballafaqova me një institucion të vërtetë, institucion me një platformë të qartë, simbolikë të qëllimtë, me etnitet të dukshëm, me anëtarësi dhe struktura shumë të angazhuara.

Dokumentim dhe Inspirim

Botimi i tribunës, gazeta “Dukagjini”- nr. 116, përmbajtja, periodiciteti i saj, më konfirmon seriozitetin me të cilin punohet në këtë shoqatë-institucion. Gazeta, jo vetëm dokumenton por, në kuptimin tim, gazeta “Dukagjini” inspiron dhe mban ndezur ndjenjën e të qenit bashkëkomunitarë, e të qenit me identitet të spikatur.

Një mirënjohje për komunitetin dukagjinat, pjesë e të cilit ndihem....

ATJE KU GJETA VETEN ...

Dëgjoja, shikoja në TV e lexoja në media për Shoqatën “Atdhetare-Dukagjini”, për veprimtaritë e saja artistike, kulturore e historike, për gazetën e saj të pagëzuar me emrin



Silvana Arrinaj

“Dukagjini”, nëpërmjet të cilave evokohej tradita, vlera atdhetare, kulturore e historike, folklori, etnografia, pamjet madhështore të zonës, bjeshkët, ujët kristal, turizmi, madhështia e burrave dhe e burrëshave dukagjinat, gjithçka e bukur, gjithçka që të sjellin emociione dhe krenari. Pra, në çdo rast me bashkëshortin tim, Ilirin, mendonim të bëhemi pjesë e kësaj shoqate, në të cilën shikonim e shikonim edhe veten tone, vendin tone, të parët tanë, prandaj në festën e numrit 100 te gazetës “Dukagjini” u bëmë anëtar të saj. Veprimtaria artistike e kulturore e organizuar, e ideuar, e përgatitur dhe e zhvilluar me rastin festes së 10-vjetorit të themelimit të saj, në të cilën dhe ne ishim pjesë e kësaj feste, tregoi se, ne kemi pasur të drejte. E ndjejmë veten krenar që u bëmë pjesë e saj dhe të japim kontributin tone modest në realizimin e misionit të saj. Vetëm, në këtë shoqate, në të cilën drejtuesit e saj punojnë me vullnetarizëm, me përkushtim atdhetarë të jashtëzakonshëm, që në çdo rast reflektojnë kulture, kulture dhe vetëm kulture, mu bë e mundur, që në këtë veprimtari të përgatitet e të behet prezent veshja tradicionale, me teme “*Bukuria dukagjinatit nder breza*”, e cila ishte një mrekulli e vërtetë, në një mjedis original-natyrall, në “*Fshatin e Paqes*”, me të cilën e ndjejmë veten mire, ndjejmë kenaqesi ne dhe pjesëmarrësit, prej të cilëve morem shume pergezime.

Ne, do të bëjmë gjithë perjekjet e mundeshme për të kontribuar në vijimin e realizimit të misionit të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”.

Në Shoqatën “Atdhetare-Dukagjini”, anëtarësimi të reja

Në çdo veprimtari të shoqatës kemi pasur anëtarësimi të reja në radhët e shoqatës, por në këtë rast, në rastin e 10 vjetorit të themelimit të shoqatës u bën pjesë e anëtarësimi të saj dhe morën përgjegjësi 22 anëtarë e anëtare, si: Angjelina Shllaku, Kole Kumbulla, Valter Lamthi, Armir Grima, Agron Hasanaj, Misarda Lumçi, Tom Zefi, Agustin Pllumbaj, Gjok Arra, Prele Zefi, Reanato Lumçi, Edita Ferlushkaj, Jetmir Rrgalla, Pavlo Vuksani, Altin Nika, Franc Bregu, Diana Bungu, Agim Martini, Donika Malaj, Amarildo Lleshi, Fatmir Vojvoda dhe Tomi Delija.

Mirë se erdhët!

PSE ERDHA NË SHOQATËN “ATDHETARE-DUKAGJINI”?

TË KONTRIBUOSH PËR VENDLINDJEN TËNDE ...



Agron Hasanaj, anëtar i ri i shoqatës

Pyetja e thjeshte: Pse erdha ne shoqaten “Atdhetare-Dukagjini”? Një pyetje e ligjshme për këdo dhe që kërkon përgjigje!

Duke qene një filiz i lindur dhe rritur në atë zone, në fshatin Nicaç, të komunës së Shalës, në zonën e Dukagjinit, aq të mrekullueshme, për mua mbetet përherë angazhimi im të jem pjesë e kontributit në mbajtjen dhe rritjen e vlerave më të mira dhe përcimit të tyre më tej. Të kontribuosh për vendlindjen tende, që ka rritur njerëz të ndenje për mbare vendin, është gjithmonë obligim që nuk duhet shmanhur.

“Unë malësor emrin e kam dhe asnjëherë nuk bëhem pishman!” Këtë postulat e gjeje më së miri në Shoqatën “Atdhetare-Dukagjini”, e cila ka dhjete vjet që punon vullnetarisht, për tu pasur zili. Ketë e tregojë dhe veprimtaria artistike e kulturore me rastin e 10 vjetorit të themelimit të saj. Një veprimtari e organizuar mire, me plote atdhetarizëm duke prezantuar kulture, art, tradite që duhet transmetuar brezave. E ndjeva veten krenar! Prandaj kërkoja të bëhem pjesë e saj dhe të kontribuojë fuqishëm, me gjithë forcat e mija në shërbim të realizimit të misionit të saj.

Profesor Gezim Uruçi - "Enciklopedia e gjallë e Shkodrës"

Në epokën e hapjes dhe të integritimit, veçmas brenda vetes, për cilindo intelektual, krijues apo studiues serioz, shanset e njohjes sa me vetveten, sa me të tjerët, janë nga më brilantët. Dhe, në këtë vështrim, njohja me individë të spikatur, në domethënie të tyre ekzistenciale, për një vullnet dhe guxim permanent, përballë sfidave në fushën e vet, padyshim dhe patjetër artikulohet brenda teje si një kënaqësi e veçantë. E kisha dëgjuar këtë emër përmes shokëve dhe miqve të tij, por asnjëherë nuk më kishte qëlluar rasti të shkëmbenim qoftë edhe dy fjalë me njëri-tjetrin. Papritur, ndërsa po kaloja para Prefekturës, kanë qenë, besoj, fillimvitet 2000, ndalon në krahun tim të djathtë një burrë i bukur, me sytë gjithë jetë, mbi një biçikletë të modelit klasik "Montabink". Dhe, ndërsa unë, po ndiqja me kureshtje interesimin e njeriut të sapoardhur, gjithë fjalë respekti dhe nderimi për qytetarët e vetmisë brilante, siç është ajo e krijuesit, ky i fundit më drejtohet: "Ju jeni Kadri Ujkaj, studiues i Kadaresë, madje edhe njëri nga idhtarët e tij më të zjarrët, së paku, në Shkodër?!". Po, i përgjigjem, i tëri, por jo si idhtar në kuptimin dogmatik, sepse idhujtaria, si prolog startimi i këtij lloj vizioni, nuk i shkon kritikut, kurse vlerësimi real i vlerave artistike po. Natyrisht, kur jemi dy, e mirëkuptoj mendimin ndryshe të tjetrit, qoftë ky edhe për "Kadarenë". Ndërkohë, si u prezantua, ai zbriti nga triçikli, përqafohem i dhe m'u lut të pinim bashkë një kafe.

Sapo kishte dalë në qarullim libri im "Kryqëzimi modern i gjenive", ku oponoja kundër gjithë asaj urdie mediokriteti, gati si një kryqëzatë kundër Kadaresë dhe Migjenit, mjerisht, në Shkodrën time, të lashtë gati sa Roma, "qytet-shtet" në specifikën e saj si identitet, të cilën, falë asaj tradite elitë në fushën e kulturës dhe të humorit, gjithnjë e kam ndërjet dhe e ndjej brenda vetes "timen", çka më ka bërë të mos hesht përballë idhujtarisë sa politike, sa të djepeve, po aq kundër konformizmit patologjik, postmodern, viruse që rrezikojnë identitetin

e çdo civilizimi, sado koherent të jetë brenda vetes.

Pikërisht në këtë kontekst sa real, sa surreal do të takoheshim për të mbetur si dy miq dhe për të mos u ndarë deri në ditët e fundit të jetës së tij, me Profesor Gezim My. Uruçin qytetarin shpirtmadh dhe hulumtuesin serioz, që urretjtjen "nuk e njihte", edhe pse i dallonte qartë ata që nuk u gëzoheshin sukseseve të shkëlqyera, sfidave të fituara prej tij, si pak kush në Shkodër, Shqipëri dhe në Evropë, në fushën e studimeve spileologjike. Vërtet ai jetonte shpirtërisht me malet dhe shpellat, por po ashtu jetonte edhe me statusin e fjalës si vlerë universale: Gezimi ishte edhe një poet që të mrekullonte. Në studion e tij ruante, si gjëra të shenjta, rreth 200 poezi të krijuara prej tij, në të cilat spikaste niveli artistik, larmia e strofave dhe vargu klasik deri tek ai modern. Nuk e di pse s'po i bontonte, ndoshta mania për të rrokur maksimalisht gjuhën poetike, në ato nivele, që ai shquhej, botërisht, në "gjuhën e spileologjisë", pasioni brilant i jetës së tij.

Dhe nuk mund të ishte ndryshe: Pasioni i jashtëzakonshëm në këtë fushë do të ishte gjithë laitmotivi i jetës së tij prej spileologu të shquar. Me orë të tëra më ka takuar të ndiqnim, bashkë, në kompjuterin e tij gjithë atë dokumentacion të fotografuar, arshivuar dhe të mbajtur me kujdes, ku mbaheshin model mbi 80 mijë negativate të skeduara sipas sistemit të mirënjohur të Fototekës "Marubi" si dhe afro 100 mijë fotografi të realizuara me aparatit e tij në veprimtari të ndryshme kulturore, patriotike, shkencore: Aktualisht një mundësi e përsosur për të performuar fotoekspozita të ndryshme lidhur me malet, shpellat, etnografinë, monumentet e kulturës, folklorin dhe objektet antike të Shkodrës dhe të të gjithë Shqipërisë. Profesor Gezimi fliste, mirë, disa prej gjuhëve të huaja, qakakam arriutur ta kuptoj sa nga të afërmit e tij, sa nga ndjekja me 3-4 orë rresht në kompjuterin e tij të punës, të ve-

primtarive të zhvilluara: konferenca shkencore, me dialogje e polemika, deri kongrese jashtë shtetit, prej ku ftesat atij i vinin së bashku me biletën e udhëtimit, me studiues gjermanë, norvegjezë, italianë, rusë, anglezë, serbë, bullgarë etj. Përvoja të tilla me



të huajt, të jipnin mundësinë që të kuptojte që ai fliste mjaft mirë: gjermanisht, anglisht, italisht, serbisht, bullgarisht dhe rusisht.

Profesor Gezim My. Uruçi gjatë viteve 90-të, që banonte në Kassel Trier, në Bon të Gjermanisë, krahas përgatitjes vullnetare, për rreth 4 vite, të studentëve për trajnerë të huaj, spileologë, në Universitetin e Bonit, do të jepte një kontribut të shquar prej patrioti edhe në përgatitjen speciale të trupave të UÇK-së së Kosovës. Rrjedhimisht, ai njihte nga afër, ruante raporte konfidenciale dhe takohej me raste, krejt miqësisht, me ish-liderët e njohur të UÇK-ës: Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Ramush Haradinajn e te tjera.

Megjithatë, fusha pasionante e tij qenë hulumtimet në spileologji, ku arriti të eksplorojë rreth 3200 shpella, brenda dhe jashtë vendit, duke merituar, kështu, në vitin 1994 sodisfaksionin e titullit "Profesor Honoris"

në shkencat spileologjike nga Unioni Internacional i Spileologjisë në Bruksel. Viti 2001- një tjetër sfidë e arriutur në spiralen e arrietjeve të Profesor Gezim My. Uruçi: Instituti Biografik i Kembrixhit e përfshin në elitën e intelektualëve më të shquar të botës. Shtoji këtij suksesi edhe vlerësimet e bëra me medalje bronxi dhe ari, në vitet 1993 dhe 2004, nga Federata bullgare e Spileologjisë, "mimin" "Juri Gagarin", në fushën e astronomisë, dhënë në Salaman-ka të Spanjës, në 1994-ën e te tjere dhe do të bindesh pse Prof. Gezim My. Uruçi do të përfshihej me aq dinjitet profesional, si njëri nga spileologët brilantë, në 8 enciklopedi ndërnacionale.

Jo rastësisht, në vitin 1995, Qendra Nacionale e Spileo-alpinëve të Shqipërisë do t'i jepte titullin "Eksploratori më i madh shqiptar i të gjitha kohërave", sikurse më 10 maj 1989 i akordohet titulli "Laureat i çmimit të Republikës" si projektues i të parit shatërvan në Shkodër. Në shtëpinë e tij një muze, por edhe një bibliotekë me mbi 6000 vëllime, në 17 gjuhë të huaja, krahas shumë librave në dorëshkrim, që presin të botohen, do të gjesh edhe thesarë të rrallë si vegla prej koci dreri për mbushjen e dhëmbëve, madje edhe dhëmbë të mbushur me pluhur kocke, zbulime fenomenale të vetë atij.

Ai ishte gjithashtu edhe themeluesi i Shoqatës Nacionale të Spileo-alpinëve të Shqipërisë në vitin 1991, sikurse edhe njëri nga anëtarët dhe bashkëpunëtorët, me të drejta të plota, i disa federatave dhe unioneve ndërnacionale, të Gjermanisë, Anglisë, Austrisë, Italisë, Spanjës, Rusisë, Kinës, Japonisë, Meksikës, Portugalisë, Afrikës së Jugut, Greqisë, Maqedonisë, Kosovës, Norvegjisë, Jugosllavisë, Francës dhe Greqisë "ka do të bënte që miku i tij, i mirënjohur prej nesh, Mjeshtri i Madh Fadil Kraja ta vlerësonte Profesor Gezim My. Uruçin "Enciklopedia e gjallë e Shkodrës" (Seminari i 6-të shkencor ndërnacional "Shkodra në shekuj", fq.123).

Nuk e kam kuptuar asnjëherë se çfarë i mungonte këtij personaliteti të shquar të spileologjisë shqiptare, evropiane dhe më gjërë, që institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë të mos i akordonte, pas gjithë kësaj karriere brilante, titullin "Mjeshtri i Madh". Megjithatë, këtij njeriu që s'kurseu asgjë nga jeta e tij, vetmohuese, për të përfaqësuar si pak kush në botë vendin e tij, Shqipërinë dhe Shkodrën që e deshi aq shumë, edhe pse kjo e fundit, borxhlije për jetë ndaj nderimit të merituar për njërin nga bijtë e saj më të denjë, si Profesor Gezim My. Uruçi, nuk do të denjonte t'i vinte në dispozicion asnjërin nga institucionet publike, pa le më Teatrin "Migjeni", në ceremoninë mortore, të përcjelljes në banesën e fundit, më 17 dhjetor 2012, të djalit të Saj. Dhe, kur kujtojmë se Profesor Gezim My. Uruçin, në vitin 1994, do të shpalojë si heroi i alpinizmit sa shqiptar, sa evropian duke ngritur në Polin e Veriut Flamurin Kombëtar të Shqipërisë, do të ndjeni neveri ndaj atij trajtimi mjerman, që i bëhej: vetëm me 4 000 lekë asistencë, në muaj, në Shkodrën "heroinë e punës demokratike" - "djepi i kulturës", pra as sa paga minimale e një pastrueseje zyre përballë atij kontributi aq elitari. Dhe, nëse doni të bindeni, ndryshe të jini vetvetja, ngjituni dhe shihni se ç'pasuri shkencore, me interes të pashoq sa nacional edhe më gjërë, ruhet në apartamentin më të epërm, të një pallati 5 katësh, me nr. 1265, në lagjen "Ura Dervishbeg" - Perash, prej ku ulej dhe ngjitej do ditë, ndryshe jetonte enciklopediku ynë, invalid, njëri nga spileologët më të shquar shqiptarë dhe evropianë. Kujtojmë se, krahas vlerësimeve të ndryshme deri atë me "Medalje Ari", Federata Bullgare e Spileologëve do ta nderonte Profesor Gezim My. Uruçin edhe me titullin tjetër të nderit: "Ambasador i Paqes në botë".

Megjithatë, le të shpresojmë që në nderim të 64-vjetorit të lindje së tij, 30 korrik 2013, këshilli bashkiak i qytetit të Shkodrës të ketë dinjitetin e duhur të reflektimit, në liri të plotë brenda vetes, siç i ka hije një parlamenti lokal, për ta nderuar hulumtuesin enciklopedik, spileologun e shquar shkodran "enciklopedinë e gjallë të këtij qyteti", Profesor Gezim My. Uruçin, me titullin "Qytetar Nderi" i Shkodrës!

Kadri Ujkaj

NË DISTANCE NDJEJA DIÇKA QË MË KËRKONTE TË AFROHEM ...



Tomi Delija

Kisha dëgjuar prej kohesh për Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", për veprimtarinë e saj dhe në distance ndjeja diçka që më kërkonte të afrohem. Njohja e pare nga afër ishte muaji qershor 2010, e cila organizoj një veprimtari kushtuar axhës tim, Piktorit Lin Delija, me rastin e dekorimit të tij, me urdhrin "Nderi i Kombit". Më vonë, vijoje me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në manifestimin "Zëri i Vëllazërimit-2013", në

Kosovë, në prezantimin e vëllimit me poezi "Mjegulla", të autorit Lazer Kodra dhe në veprimtarinë artistike-kulturore me rastin e 10 vjetorit të themelimit të shoqatës. Në gjithë këtë pjesëmarrje të timen, më bën Tri gjera që më ngashënjëjnë n' anëtarësim të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini": a) respekti për legjislatorin e madh të nacionalitetit tone Lek Dukagjini; b) pënderimi që u tregua për Lin Deline dhe c) dashuria për me rrejtun traditën në përputhje me bashkëkohoren. Duke u nisur nga këto, i thash vetes që duhet edhe unë të jap kontributin tim modest në realizimin e misionit të kësaj shoqate, pasi edhe unë jam pjesë e këtij geni.

PRINDËRIT E MI, MA KANE USHQYER SI VLERE QË NUK DUHET HUMBUR ...

Kam kohe që ndjeje të jem pjesë e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini",



Altin Nika

sepse në veprimtarinë e saj, në punën e saj, në realizimin e misionit të saj, çdo dite shikoja një përkushtim mjaft të madh vullnetar të drejtuesve të saj, çka më bënte të ndjeja veten më shumë krenar që jam pjesë e këtij identiteti, të cilën e pashe më së miri në veprimtarinë artistike e kulturore që organizoj dhe dha, me rastin e 10 vjetorit të themelimit të saj. Prandaj dëshiroj që të jem pjesë e identitetit dukagjinan, ku gjyshi im e ka jetuar dhe prindërit e mi, ma kane ushqyer si vlere që nuk duhet humbur, por ruajtur e përçuar dhe më tej, duke jua lenë brezave trashëgim, për të cilën brezi i im ka një obligim të veçantë.



SHOQATA "ATDHETARE-DUKAGJINI" NË 10-VJETORIN E SAJ

"PLAKUT E PLAKES DËGJOI FJALËN POR JO ..." AMANETET PLAKAVE PËR T'I VARROSUR
ME XHUBLETA, JANË ... QË NUK DUHET DËGJUAR!

Me datën 30 qershor 2013, në mjesdiset e "Fshatit të Paqes", Shoqata jonë, "Atdhetare-Dukagjini festoj 10 vjetorin e datëlindjes së saj.

Faleminderit gjithë ati auditori të shkëlqyer me gjeografi të gjerë që nga Tirana, Peja Gjakova, Gucia, Rozhaja. Malësia e Madhe, Tuzi, Puka, Lezha, nga Shkodra (po se po) dhe nga diaspora dukagjinase duke filluar nga SHBA, Italia, Greqia e vende të tjera të Bashkimit Evropian ku punojnë e jetojnë bijtë e bijat e komunitetit tonë.

Falënderojmë për prezencën e tyre: Prof. Dr. Mahir Hoti, Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, Prof. As. Dr. Ahmet Osja, Prof. As. Dr. Zef Gjeta, Kryetarin e Këshillit të Bashkisë Shkodër, av. Bardhyl Lohja, prof. Dr. Tomorr Osmani, Drejtori i bibliotekës "Marin Barleti", Gjovalin Çuni, Sekretarin e Lidhjes së Shkrimtarëve Shkodër, Dashmir Cacaj, kryetarin e Forumit FZM, kryetarin e komunës së Dajçit të Bregut të Bunës, Arben Gjuraraj; poet studiues gazetare të gjitha mediave vizive të qytetit Shkodër, Malësi e Madhe, Puke dhe Lezhe. Falënderimet më të mira meritojnë realizuesit e kësaj veprimtarie: regjisori Aleks Dushi e Roza Pjetri, Silvana Arrinaj, Dukate Bregu, Lulash Brigja dhe Anton Kosteri; recituesit: Aktorin Tomi Delia, Djana Bungu me gjithë shoqet e veta simpatike Dritmira Hyseni e Arlinda Kallaçi, grupin e valleve të koreografit Aldo Nika; interpretuesen e vogël, Alenda Mehmeti, të këngës Marçelo dhe interpretuesen e shkëlqyer te muzikës se lehte, Flora Shtylla; legjionarët e grupit

"Treva": Fran Kodra, Ndue Shytani, Pëllumb Vrinca, Agustin Pllumbaj dhe Gëzim Zefi; grupin e valleve të Rugovës, të përberë nga Florim Nikçi dhe Besim Zabeli, së bashku me Drejtuesit e Shoqatës së vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me kryetarin e tyre Ukshin Jashari; kryetarin e ansambllit "Dede Gjon Luli" në Tuz, Gjon Dushaj; Kryetarin e degës së shoqatës "Martin Dreshaj" në Tuz, Pal Dreshaj, me Anton Lulgjuraj. Pa mëdyshje Kryetarin tone, Ndue Sanaj, i cili ishte i pa lodhur dhe këmbëngulës në arritjen e suksesit.

Ishte një veprimtari shembullore, me një larmi dhe konfigurim interesant, ku në qendër të vëmendjes ishte vlerësimi, i themeltarëve të shoqatës, i veprimtarëve



Kantautori Fran Kodra dhe këngëtarët Ndue Shytani e Agustin Pllumbaj



Grupi i valleve, me koreograf Aldo Nika



Prezantuesja e veprimtarisë së 10 vjetorit të shoqatës, Diana Bungu

të saj, i personaliteteve, që nuk jetonin më, i miqve, dhe mbështetësve financiarë të veprimtarive tona.

Pjesëmarrja dominuese e gjithë atyre vajzave dhe djemve të ri, veshur me kostume tradicionale dhe vello bashkëkohore ishte vërtetë surprizuese, ishte mozaiku i rrezatuese këtij eventi, ishte hijeshia, sensualiteti dhe filladi i mirëpritur i kësaj dite verore, ishte kurora me dafina e mbi kokën e Shoqatës tonë 10 vjeçare, avokatores, promotores dhe prezantatores, së vlerave të kulturës dukagjinase, bujtinës bujare te elitës krijuese

e shkencore, e kthyer tashmë në Institucion ashtu siç e perifrzoj me një metafore të shkëlqyer vajza e te paharruarit

Nikë Pali, Marijana Sinani.

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" më tepër se kurrë sot, i ngjau një gjerdani me xhevahire të çmuar ku e shkuara e tashmja dhe sotmja vinin krejt natyrshëm të lidhura rrëfanë në mënyrë të pa ndashme krah për krah nga brezi i tretë i përfaqësuar gjithë finesë nga mustaqe shtillungosuri e çakçirë-bardhe Zef Lulashi, për te vazhduar me gjithë atë armatë shtojzovallësh me xhubleta shekullore, hirushesh rrezatore velbardha deri tek trëndafiloret e brezit të mitur që ishin qershia mbi tortë e gjithë kësaj sfilite të ndërtaur thjeshtë, larg skemave të gatshme që vërehen herë pas here në shfaqje të tilla. Ka qenë një punë lodhshme, madje sfiduese, gjetja e gjithë këtyre kostumeve që patëm rastin të shfaqen në ambientet e mrekullueshme të fshatit të Paqes. Ka qenë një "vjedhje" që Dukatja e Silvana, gjithë këto vajza të reja kanë bërë në arkat e gjysheve të tyre, fanatikë që këto pak xhubleta që na kanë mbetur, nesër ose pas nesër do na i marrin në boten tjetër, pasi duan të varrosen me to, ashtu siç ua kërkon tradita i etërve të vjetër.

Për këtë ekspozitë, jo vetëm falënderojmë, për idenë dhe përkushtimin e pa kursyer te anëtares se shoqatës, Silvana Arrinaj, por dhe për paraqitjen e kos-

tumeve te nusërisë me vello, te cilat ishin te gjitha te sallonit te saj. Falënderojmë edhe Zef Lulashin, i cili beri te mundur sigurimin e 20 veshjeve popullore për burrave, për nuseve, për vajza dhe për fëmijë. Falënderojmë gjyshen e Hana Rrgalles, te Silvana Arrinaj, te Leonora Milanit, (me dy pale), hallën e Dukate Bregut, te cilat bene te mundur veshjet e traditës sa me origjinale. Falënderojmë pronarin Bar-Restorant "TRADITA", Gjon Gilen për sigurimin e veshjes se Donika Males.

Nga njëra anë jam ngazëllyer nga gjithë kjo kostum-monografi me të cilën vajzat tona (gjimnaziste dhe studente), përformuan gjithë krenari e pasion, ndërsa nga ana tjetër ndjeja dhimbje keqardhje, për shumë aksesore që i mungonin të këtyre veshjeve, me xhubletë, të cilat këto vajza dhe veshëset e tyre me finesë janë munduar t'i kompensojë me zgjuars, por nuk janë aspak fajtores perse gjyshtet dhe stërgjyshtet e tyre këto aksesore i morëm me vete dhe së bashku me traditën e punimit të tyre. A ma solle xhubletën i tha gjyshja ime, stërmbesës së vet vajzës time. Po, po gjyshe e kemi te bagazhi i makinës së babit ju përgjigj vajza. Shko, paste lokja e ma fut në arkë se, më duhet për dekë, e këshilloj plaka, e cila nuk e përfytyron dot varrosjen pa xhubletë. Trishtohem, kur ajo pas disa vitesh, por ndoshta edhe pas disa muajsh nuk do t'i kemi as këto pak xhubleta që kishim sot, të mbetura si reliket më të çmuara të veshjeve tona tradicionale. Xhubleta është veshja mijëra vjeçare, pasaporta e vetme autentike iliro-shqip-tare. Të varrosësh një xhubletë, kur sot teknika e punimit të tyre ka vdekur, është një krim, është një vrasje e një veprë të mirëfilltë arti. Ndaj, ju bej thirrje gjithë atyre të rinjve e të rejave t'u imponohen në mënyrë rebele prindërve dhe gjysheve të tyre, duke u thënë sos, varrosjes së rrobave tradicionale te nacionalitetit tone. Një xhubletë kushton më "shtrenjtë" se, 100 plaka të vdekura së bashku. Një fjalë e urtë popullore thotë: "Plakut apo plakes dëgjoji fjalën. por jo ...". Gjyshtet le t'i respektojmë sa të jenë gjallë duke u shërbyer me mirësjellje e devocion. Ndërsa amanetet e tyre, për ti varrosur me xhubleta, janë ... që nuk duhen dëgjuar!

Kjo veprimtari, veprimtaria e festes se 10 vjetorit te themelimit te shoqates "Atdhetare-Dukagjini" u mundesua nga: Famullia Shen Shtjefni ne Shkoder, Sivana Arrina, Gjergj Leqejza, Mark Rupa, Ndue Mici, Ndue Ftoni, Gjon Shtyllza, Luigj Mila, Gjergj Vocaj, Mirjana Sinani, Ndoc Bjeshkes, Ndue Sanaj, Prele Milani, Luigj Shyti, Anton Kosteri, Syka Çarku, Prele Shytani, Fran Preçi, Gjon Fierza, te cilet i falenderoj dhe i uroj me shprehjen popullore: Paçin faqene bardhe!

Përgatitur nga PREL MILANI



Këngëtari i këngëve të "buta", Plumb Vrinca



Këngëtari nga Peja, Besim Zabeli



Titullin "NDERI" për gazetën "Dukagjini" e tërheq Kryeredaktori i saj, Lazër Kodra



Gjergj Leqejza, "NDERI" i shoqatës



Valltaret Florim Nikçi dhe Besim Zabeli nga Peja



Luigj Shyti, "NDERI" i shoqatës

POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI

DELI PJETËR - "THAÇIT"

Vikatë "zana" e Miliskaut
Dridhet toka e ushton bjeska
Si rrufe shkrep mbi xhandarët
Tmri i Thçit Deli Pjetra

Hypi i shqipe n'maj t'krepit
L'shon nji za që ka dridhë tokën
Po ku janë xhandarët e Mbretit
Djegë në kullë ma kanë Nanloken

Nuk ka "pritë" me ja ndal ë turrin
S'e ndal ë pushka as gjylja e topit
Mbi xhandarët ka shpërthyer vrullin
Deli Thaçi – "ujku" i hordopit

Idhët i sheh muret e kullës
Mbrënë nan – loken djegun zharg
Si rufe del n'shteg të rrugës
Ballë për ballë me i togë xhandarë

Bash si ujku mbi kope
Që s'len dele, dash as skjap

Shumë xhandarë ka shtri për dhë
E nji ma të fortin n'fyt e kapë

Mbasi e shtrinënë tokë, Delia
Me i nxjerrë shpirtin për gazep
N'krah e ven, niset te shpia
N'mullar t'dushkut don me djegë

Ndalë e kanë burrat e fisit
Afër kullës n'at breg zallit
Ndal: Deli, për hirë të Krishtit
Mos e digj atë djalë për s'gjallit

Me i herë turrin e ka ndalë
Siç ndal shkëmbi dallg't e detit
Për ju burra, jam tuj e falë
Çka i panë syta, t'ja kallzojnë Mbretit

Kur ti mbledhin mercenar't ë
Me "kullotë" ndër kneta e fusha
Mos t'i lshojnë bjeshtëve "zagarët"
Se k'tu ka "ujq" e "harusha".

MARK BREGU

ZINA FRANJA U NDA NGA JETA

Një sëmundje e rënde dhe e gjate, me datën 11 korrik 2013, i mori jetën, njërës nga luftëtarët më të paepura për emancipimin e shoqërisë dhe në veçanti të femrës shkodrane; njërës nga veteranet e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare; Anëtare së Nderit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", trimëshesh dukagjinase, të paharruarës Zina Frani (Plani), që akoma e donim ta kishim në mesin tone jo vetëm fizikisht, por mbi të gjitha për mendjen, për urtinë dhe arsyetimin e saj, vajza Geti, dhëndri Tonini, nipat Sokoli, Eugeni e Juliani dhe të afërmit e saj, komunitetit ku jetonte dhe ne, veteranet dhe anëtarët e shoqatës.

Zina Frani, lindi në qytetin e Shkodrës, me 10 dhjetor 1928. në familjen Plani, nga fshati Plan, në familjen, Tom e Lena Plani, çifti simbol i malësorit dukagjinase dhe shkodrane, jo vetëm çifti simbol i jetës bashkëshortore, por edhe çifti punëtor e i përkushtuar në jete dhe në shërbim të gjithë mjedisit ku jetuan e punuan. Pra, Zina e jone ishte pjese e kësaj familje me emër në Dukagjin, me emër në Shkodër, me emër kudo që pjesëtarët e saj jetuan e punuan

Ajo, në moshën 15 vjeçe u bë pjese e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare të vendit. Në fillim, me shpërndarjen e trakteve, me Zef Deden, Ndue Vata, Niko Pistulli dhe Mark Plani. Ajo për një kohë punoj në qytet dhe në rrethinat e tij deri sa u ra në sy të agjenteve në shërbim të pushtueseve, nazistëve Gjerman dhe u vendos të largohet nga qyteti. Për këtë baba i saj, me Tom Ndoken, e strehuan në fshatin Plan. Në muajin shtator 1944, organizohet në Rininë Komuniste Shqiptare, me Gac Mazin e Tano Banushin. Gjate Luftës Nacional-Çlirimtare punoi me shume personalitete dhe figura të nderuara, si me vëllezërit Kole e Mark Prelen, me Mark Ndojen dhe

Zef Malen, me të cilët nuk kursyen asgjë për përparimin shoqëror.

Zina Franja, me një jete me plote pune, mund, sakrificë dhe ndershmëri, shembulli në përpjekje për emancipimin e gruas malësore dhe qytetare shkodrane.



Pas çlirimit të vendit, Zina ka kryer shume detyra dhe ka dhënë kontributin e saj te jashtëzakonshëm kudo qe jetoj e punoi. Ka filluar punën shitëse në manufakturë. Më vonë, në Komitetin Ekzekutiv, referente në sektorin e tregtisë. Në vitin 1946, emërohet sekretare e Këshillit të qytetit Shkodër. Në vitin 1948 emërohet Drejtoreshë e Jetimores, që varej nga sektori i shëndetësisë. Në vitin 1950, emërohet Drejtoreshë e Spitali "Jorgji Karamitri" dhe ka punuar deri në vitin 1953. Nga fundi i këtij viti, emërohet Kryetare e Gruas për Qarkun Shkodër, që përfshinte: Shkodër, Puke, Lezhe dhe Malësi e Madhe. Në Pranverën e viti 1966, zgjidhet

dhe emërohet Sekretare e Komitetit të Partisë së Punës, për rrethin e Shkodrës. Në fund të vitit 1977 emërohet Kryetare e Frontit për rrethin e Shkodrës. Në vitin 1984 del në pension.

Ajo ka qene deputete në katër legjislatura, deri N/kryetare e Kuvendit dhe anëtare e Presidiumit të Kuvendit Popullor; anëtare e Kryesisë së Përgjithshme të Gruas, anëtare e kryesisë së Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe kandidate e Komitetit Qendror të Partisë së Punës.

Ajo, në të gjithë detyrat u paraqit punëtorë e ndershme, e përkushtuar, me aftësi profesionale, organizatore e afte, e vendosur në realizimin e tyre, gjakftohtë në marrjen e vendimeve, me respekt dhe dashuri njerëzore, e dashur dhe komunikues me njerëzit. Ajo, mbi të gjitha u paraqit kudo, **NJERI!** Për të gjitha këto kontribute, për punën e saj te veçante si femër, si dukagjinase dhe si shkodrane është vlerësuar duke u dekoruar me 12 urdhra dhe medalje.

Ajo, me 20 shtator 1950, krijon familjen duke u martuar me Zef Franja, të cilët kane një vajze, Getin. Atë e rriten me dije e kulture të gjere, e cila sot ndodhet në SHBA, në Kolorado, me bashkëshortin e saj, Tonin Fistanin dhe me dy djemtë Eugenin e Julianin, për të cilët kishte një mall e dashuri të veçante. Ajo, në një takim, neper mjet gazetës "Dukagjini" ju la ketë porosi: "*Zemrat e Nënës, mos e harroni vendin ku keni le, keni kryer shkollën, jeni edukuar, keni krijuar familjen, keni mundin tuaj. Ju dua shume! Të ktheni sytë nga ky vend*".

Zina, nuk ishte vetëm një bashkëshorte e shkëlqyer, nuk ishte vetëm një nëne e mire, por ishte dhe një e afërme e mire, një kolege e mire, një fqinje e mire, një shoqe e mire, një bashkëpunëtorë e mire, për të cilën të gjithë kishim akoma nevojë për te, për fjalën e saj, për mend-

jen e saj, për shoqërinë e saj, për fjalën e qete dhe shume dashamirëse, të cilat i kujtojmë sot me shume respekt.

Jeta e **Zines** ishte e mbushur me shume mirësi, me shume vlera të trashëguara nga të parët e saj, duke i paraqitur ato kudo që prezantohej. Kudo dhe kurdoherë paraqiti vlerat më të mira të një njeriu të vërtetë, të një njeriu të kohës, vlerat e një njeriu me virtytet e larta të një malësoreje e qytetare të denje. Prandaj, është krenar vajza Geti për nënën e saj, Zina, janë krenar nipat për hallën e gjyshen e tyre, Zinen; janë krenar te afërmit e saj, për Zinen; janë krenar veteranet për shoqen e tyre, Zinen; jemi ne, anëtarët e shoqatës për kolegen tone, Zinen; janë krenar të gjithë bashkëqytetarët e saj; janë krenar gjithë kush e njohu e punoi sadopak me Zinen. Të gjithë kemi se, çfarë ti kujtojmë Zines tone të paharruar.

Zina ishte një mike, me të cilën mund të bëje dy hapa të sigurte. Kjo mike, Zina, do na mungojë! Do ti mungojë të gjithëve, vajzës Geti, dhëndrit Tonini, nipave, Sokolit, Eugenit e Julianit dhe të afërmeve; do të na mungojë edhe ne, miqve dhe mikeshave të Zines, por dhimbja asnjëherë nuk ka qene dhe nuk ka për të qene e aftë kurrë për të kundërshtuar jetën, prandaj, Ju them: Zina ju paste lenë jetën, mirësinë dhe mbarësinë.

Të gjithë kemi humbur, me humbjen e Zines, por Zina me jetën e kontributin e saj, në mes nesh ka mbetur e gjalle!

Në emër të Organizatës së Vetëneve në Shkodër, të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në emër të miqve dhe mikeshave te saj, te dashurve dhe te afërmeve te saj shprehim ngushëllimet më të sinqerta!

Zina Franja, lamtumire, i lehte të qofte dheu, shpirti të pushoftë në paqe!

Ndue Sanaj, Vehbi Fishta, Gjergj Leqezja, Luigj Shyti, Ndoc Grima, Adem Vokshi, Kel Reshpja, Suzana Peci, Pal Lera, Halil Vogli, Ndue Mici, Lazer Kodra, Roza Pjetri, Gjergj Çuni e Mirash Ujka.

Lulzim Basha, kryetari i Ri i Partisë Demokratike

NË FJALËN E TIJ TË PARË, PER MENDIAT NE MES TE TJERAVE THEKSOI:

"Falenderoj anëtarët, strukturat dhe drejtuesit, për vlerat e larta qytetare me të cilat u angazhuan në këtë proces. Në këtë garë të parën të vërtetë, ne demokratët iu dëshmuam qytetarëve se jemi përfaqësuesit më të denjë të lirisë, demokracisë e dinjitetit. ... Ne nuk harrojmë që jemi të gjithë demokratë, anëtarë të një familjeje, më të vendosur dhe më të bashkuar se kurrë ... Në përpjekjen time për ta drejtuar këtë fillim të ri, do të jap gjithçka me vendosmëri absolute dhe përgjegjësinë më të lartë ndaj jush, anëtarëve dhe militantëve të PD. Do mbështetem te vizioni i themeluesve, Azem Hajdarit dhe qëndrestarëve të tjerë, te energjia e pamatë e militantëve dhe anëtarëve, te përvoja e drejtuesve sot e ndër vite, te pasuria e vlerave të leadershipit historik, Sali Berishës. Do punoj që PD, e lindur nga ëndrrat e të rinjve, të jetë forca e ëndrrave të tyre, gjeneratës së lirisë. Bashkë me ta kemi fituar, bashkë me ta do u japim krahë fitoreve të ardhshme ... Detyrat që na presin nuk janë të lehta, sfidat janë të mëdha. Gjatë rrugës sonë kemi treguar se, sa herë kemi qenë të bashkuar, të vendosur, jemi përballuar me sukses dhe kemi fituar. Ne do të ndërtojmë një opozitë të fortë, ballore dhe alternative. Për çdo problem, në çdo sektor shqiptarët do shohin zgjidhjen tonë. Do jemi çdo ditë kudo, me të përndjekurit, pronarët, botën akademike, gratë shqiptare, rininë, të moshuarit, pakicat, në krah të çdo qytetari ... Ne jemi partia e taksave të ulëta dhe konkurrencës së ndershme. Ta nisim rrugëtimin tonë së bashku, me ballin lart, për vlerat tona, për të shkuarën, misionin tonë, dhe t'u japim shqiptarëve jo vetëm një opozitë të fortë. Ta kthejmë PD-në në udhëheqje të projektit tone.

REDAKSIA



PS-ja DHE LSI-ja, FESTOJNË FITOREN E PËRBASHKËT

Rama: "Shqiptarët dhanë në këto zgjedhje proven shembullore të Atë Gjergj Fishtës, se "Për me sundue nuk asht e mjaft vetmia, dredhia, intriga, batakçillëku, rrena, tradhtia. Duhet nder, dije, urti dhe burri. Qe se c'ka duhet!"

"Unë jam i bindur se nën qeverisjen tonë shtypi do të jetojë ditët e veta më të mira dhe liria në tërësi do të fitojë një cilësi që nuk e ka pasur deri më sot."

Partia Socialiste në 22 vjetorin e themelimit të saj si dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë festuar së bashku fitoren e zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit më datën 1 Korrik në ambientet e Hotel "Sheraton", në Tiranë. Në prani të Kryetarit të LSI-së Ilir Meta, të Zv/Kryeministrit të Parë të Kosovës Behxhet Pacollit, Zv/Kryeministres të Kosovës, Mimoza Kusari, të përfaqësuesve të Trupit Diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe të mjaft gazetarëve dhe analistëve të pranishëm. Fjalën e rastit e mbajti Kryetari i PS, Edi Rama dhe Kryeministri i zgjedhur i shqiptarëve, i cili ndërmjet të tjerash u shpreh: "Faleminderit nga e gjithë Partia Socialiste dhe aleatët e saj, skuadrave tona të rilindjes në çdo qark. Më në fund pas vitesh të trazuar për të majtën, le ta gëzojmë këtë rilindje së bashku me një fitore plebishitare që e arritëm të bashkuar. Më lejoni që të falenderoj sonte në mënyrë të vecantë aleatët tanë strategjikë, të Levizjes Socialiste për Integrim dhe personalisht Ilir Metën, për gjithcka bëri nga ana e tij për interesin e madh të familjes së socialistëve dhe progresistëve shqiptarë, për interesin e vetë Shqipërisë në mënyrë që të fitonte kundër ndasive të së shkuarës ndërmjet nesh. Jam i bindur se, koha do ta provojë edhe në qeverisje atë që 23 qershori provoi në zgjedhje. Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim janë dy parti që si një fuqi e vetme mund të bëjnë histori në këtë vend. Një milionë shqiptarë na kanë dhënë mandatin e plotë për t'i udhëhequr në rrugën e rilindjes së vendit dhe për të ecur më shpejt drejt Shqipërisë Evropiane. Ne e dimë mirë se ata nuk votuan për të ndryshuar thjesht qeverinë, por vendin ku jetojnë, jetën e tyre në këtë vend dhe vetë politikën e këtij vendi. Dhe detyra jonë, të zgjedhurit e tyre është që tu përkushtohemi synimeve që i ngritëm masivisht njerëzit në revolucionin e heshtur me votë

të 23 qershorit. Por kujdes! Ky që keni marrë është një mandate sa i fortë numerikisht në sallën e Kuvendit aq edhe i brishtë politikisht përballë pritshmërisë

Ndërkohë, duke u ndalur në rrugetimin në opozitë për 2 mandate të kësaj partie, ngjarjen tragjike të 21 janarit 2011 si dhe të metat që u konstatuan në



Kryetari Edi Rama, duke mbajtur fjalën në festën e PS-së

së jashtzakonshme të njerëzve. Njerëzit na kanë dhënë një fuqi të madhe për të qeverisur, por edhe na ka ekspozuar përballë një rreziku të cilin në asnjë çast nuk duhet që ta harrojmë se, e kemi aty; pra në çdo hap, në se ne do të harronim se, kjo fuqi na është dhënë për vendin e jo për vete, atëherë dëmi që do t'i bënim Shqipërisë do të qe shumë i rëndë. E po ashtu, i pashlyeshëm do të qe edhe zhgënjimi i hidhur që do të linim në zemrat e njerëzve, të cilët na kanë testuar kaq masivisht. Shqiptarët dhanë në këto zgjedhje proven shembullore të Atë Gjergj Fishtës, se "... për me sundue nuk asht e mjaft vetmia, dredhia, intriga, batakçillëku, rrena, tradhtia. Duhet nder, dije, urti dhe burri. Qe se c'ka duhet!"

opozitë, Rama vijoi:

"Kur 7 vjet e gjysëm më parë erdha në krye të Partisë Socialiste vendosëm së bashku një sërë objektivash në funksion të rikthimit në qeveri si një forcë e re politike me një vizion të ri, program të ri, skuadër të re. Rruga nuk qe aq e shkurtër sa ç'e dëshironim. Ndashëm pengesa të mëdha dhe zhvilluam bëteja jo të lehta. U vodhëm në zgjedhje, u goditëm me baltë në fytyrë dhe u sabotuam pas kurizit. U rënduam shpirtërisht prej cinizmit përreth dhe u drobitëm fizikisht në rrugën e rezistencës opozitare me protesta të panumërta dhe më një grevë urie unikalë vetëm e vetëm për lirinë e zgjedhjes. Humbëm 4 jetë të pafajshme njerëzish, për të cilët shpresoj që

të jenë më të qetë aty ku prehen, dhe këtë e di mirë se, nuk do të jenë kur-rë plotësisht të qetë pa u bërë drejtësi për vrasjen e tyre. Në rrugën e opozitës bëjmë edhe gabime pa dyshim. Le të gjykojë koha nëse duke mësuar prej tyre e lehtësojmë gjykimin e kohës për to. Por më në fund ia dolëm dhe ia kemi dalë në mënyrën më të bukur. I kemi dhënë vetes më fitoren e bujshme të 23 qershorit të drejtën më të plotë që të jemi krenarë në përmbylljen e këtij kapitulli të jetës opozitare të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Do të doja shumë që sot të mos mungonin ndërmjet të ftuarve Dritan Hoxha, njeriu që drejtoi për këtë popull një institucion të pavarur në mbrojtje të lirisë të të gjithëve dhe Ardian Klosi, njeriu që u shkri si qiriri mes nesh në mbrojtje të flakës së lirisë së brëndshme qytetare të një individi të vetëm."

Mbylljen e fjalës së tij përshëndetëse për të pranishmit, Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama i kushtoi gazetarëve, për të cilët theksoi: "Më duhet që të falenderoj të gjithë njerëzit e shtypit, të cilët në vite tejet të vështira të këtij vendi, e ushqyen shpirtin opozitar. Tani do të kemi mundësinë dhe kënaqësinë e madhe tu provojmë se sa shumë gabojmë kur më shohin si diktatorin e radhës. Unë jam i bindur se nën qeverisjen tonë shtypi do të jetojë ditët e veta më të mira dhe liria në tërësi do të fitojë një cilësi që nuk e ka pasur deri më sot. Duam t'i japim Shqipërisë forcë dhe besim në sytë e botës përmes një drejtuesi, i cili do ta bëjë këtë vend që të shihet me respekt në Evropë dhe që të dëgjohet me respekt në rajon. Mandati i 23 qershorit është një mandat i qartë si drita e diellit për të modernizuar Shqipërinë, për të marrë vendime kurajoze dhe për të vepruar me vendosmëri, për të mos përçarë për të sunduar, por për të bashkuar. Ecim më shpejt në rrugën e rilindjes me nder, dije, urti dhe burri. Për 8 vjet në opozitë mund të flisnim, por s'bënim dot gjë. Sot mund të flasim, por do të gjykohe mi vetëm nga ato që do të bëjmë. Sepse parandaj quhemi Partia Socialiste e Shqipërisë. Por të gjithë së bashku me LSI-në dhe me të tjerët, prandaj quhemi Aleanca për Shqipërinë Evropiane. Edhe një herë gëzuar datëlindjen e Partisë Socialiste. Ju faleminderit me zemër të gjithëve!"

ARBEN LAGRETA

MALËSIA E MADHE, NDERON KADRI UJKEN

Në N/Prefekturën e Malësisë së Madhe- "Nderi i Kombit", tregohet përkushtim dhe vëmendje ndaj punës dhe kontributit të studiuesve apo qytetarëve të letrave shqipe! Kështu, kohet e fundit N/Prefekti i Malësisë së Madhe, Sytki Ndreca ka nderuar me një respekt dhe vëmendje të veçantë kontributin e njohur publik të shkrimtarit, studiuesit, publicistit dhe analistit, kritikut letrare, Kadri Ujka, me "Certifikatën e Mirënjohjes", me rastin e 102 vjetorit të Kryengritjes së Malësisë së Madhe, të vitit 1911, me



motivacionin: "Për kontribut të shquar në promovimin e letërsisë dhe kulturës në tërësi të trevës sonë Malësi e Madhe me botime librash dhe me publikime në media të shkruara dhe vizive".

Të gjithë ne, që e kemi ndjekur nga afër apo përmes medias veprimtarinë prej intelektualit të guximshëm, bashkëkohor, tolerant dhe largpamës: me fjalën e gjetur, me kulturën e veçantë, me angazhimin publik në veprimtarinë letrare-kulturorë, me debatet publike televizive, apo në veprimtaritë shkencore në

Malësinë e Madhe, në Shkodër apo në Mal të Zi të Kadri Ujkajt, kemi vene re në personin e tij studiuesin, intelektualin apo kritikun letrar që manifeston me një kuraja të jashtëzakonshëm fale horizontit të gjere kulturore, vizionit të kthjellët modern për përcjelljen e mesazheve publike me karakter human sa civil dhe aq kundër konfliktualitetit. Mik i te gjithëve, miku i Shoqatës sonë, "Atdhetare-Dukagjini" që me krijimin e saj. Nderimi qe i behet mikut tone, Kadri Ujkes, është dhe nderim për ne, çka na bën ta ndjehmë veten mire me një mik të tillë.

Le të jete ky rast i N/

Prefektit Ndrecajt një apel i fuqishëm tek të gjithë pushtetarët lokale dhe qendrorë për të pasur kurdoherë në vijimësi vëmendjen, përkushtimin dhe motivimin në të gjithë aspektet statusin e shkrimtareve dhe artisteve tanë.

I nderuar Kadri Ujka, le të shërbejë ky vlerësim që të dha vendlindja, për një obligim më të madh në punën tuaj krijuese dhe në fushën e kritikës letrare!

Gjergj Çuni



Me rastin e 10 vjetorit të themelimit të shoqatës, u nderuan me tituj nderi

NDERI I SHOQATËS

1. Gazeta "Dukagjini", me motivacion: "Zëdhënësja më e fuqishme dhe evidentuesja e vlerave të Dukagjinit dhe të dukagjinase në shekuj"
2. Luigj Shyti, me motivacion: "Nismëtar në krijimin e Shoqatës dhe kontribuues intelektual në vijueshmërinë e punës për realizimin e misionit të shoqatës"
3. Prele Shytani, me motivacion: "Nismëtar i krijimit të shoqatës, ideator dhe veprimtar aktiv, i palodhur në realizimin e misionit të saj"
4. Pal Lera, me motivacion: "Nismëtar i krijimit të shoqatës, mbështetës aktiv i veprimtarive në realizimin e misionit të saj në këto 10 vjet"
5. Mri Kroj, me motivacion: "Nismëtare dhe aktiviste e përhershme në realizimin e misionit të shoqatës. Përfaqësuese e denje e vlerave të femrës dukagjinase"
6. Prof. dr. Zef Gjeta, me motivacion: "Veprimtar i shquar i shoqatës në realizimin e misionit të saj, vlerë intelektuale në gjirin e saj dhe në nivel nacional"
7. Ndoc Bjeshka, me motivacion: "Burim frymëzimi për të gjithë. Shëmbëlltore e NJERIUT që e adhuron JETËN në çdo cep e moment të saj"
8. N/kolonel Petrit Çuni, me motivacion: "Vlerë intelektuale në fushën ushtarake. Përfaqësues dinjitoz i vlerave më të larta të urtësisë, vendosmërisë dhe bashkëpunimit tradicional dhe bashkëkohorë"
9. Nikoll Vocaj - Sekretar i degës së shoqatës në Lezhe -pas vdekjes, me motivacion: "Për urtësinë, dashurinë dhe respektin e përhershëm, tolerancën dhe bashkëpunimin brenda shoqatës, me gjithë komunitetin ku punoi dhe jetoi, në veçanti me atë dukagjinase"
10. Ndue Ftoni, me motivacion: "Mbështetës kryesor dhe i përhershëm i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" në përmbushjen e misionit të saj. Bashkëpunëtor i palodhur në të mirë të vendlindjes dhe gjithë Shqipërisë"
11. Gjergj Leqejza, me motivacion: "Mbështetës i gjithanshëm i shoqatës, gjeneratori i ideve në të gjithë veprimtaritë në përmbushjen e misionit të saj"
12. Komuna e Pultit, me motivacion: "Për mbështetje të pakursyer financiare dhe përkushtim në përmbushjen e misionit të shoqatës në të gjitha aspektet e jetës së saj 10 vjeçare"
13. Mhill Prroni, me motivacion: "Për kontribute të vlefshme financiare në realizimin e misionit të shoqatës në jetën e saj 10 vjeçare"

ANËTAR NDERI I SHOQATËS

1. Prof. dr. Shefik Osmani, pas vdekjes, me motivacion: "Lëvrues universal i gjuhës Shqipe. Vlerë e përhershme në rrafshin intelektual. Studiues dhe përkrahës i vlerave dukagjinase"
2. Zef Gjoni-Trajneri i ekipit të boksit në Shkodër dhe të Shqipërisë, me motivacion: "Trajner i pasionuar i skuadrës së boksit të klubit "Vllaznia" të Shkodrës dhe të Shqipërisë, i suksesshëm për përgatitjen dhe zhvillimin e këtij sporti në nivel nacional dhe ndërnacional"
3. Shkrimtar Lazer Stani, me motivacion: "Shkrimtar i talentuar dhe vizionar. Veprimtar aktiv i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
4. Prof. dr. Mahir Hoti, me motivacion: "Intelektual vizionar. Përkrahës i përhershëm i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" në realizimin e misionit të saj dhe malësorëve dukagjinase"
5. Prof. dr. Romeo Gurakuqi, me motivacion: "Intelektual vizionar. Përkrahës i përhershëm i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj dhe malësorëve dukagjinase"
6. Gjergj Perluca, me motivacion: "Intelektual vizionar. Mbështetës i përhershëm në realizimin e misionit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
7. Av. Bardhyl Lohja, me motivacion: "Vlera më përfaqësuese e pushtetit lokal; mbështetës i fuqishëm i shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"; vetëdije e larte në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji"

MIRËNJOHJA E SHOQATËS

1. Bibliotekës "Marin Barleti", me motivacion: "Për kontribut të shquar në vlerësimin dhe përcimin e vlerave intelektuale të qytetit tone. Për mbështetjen e pakursyer të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
2. Fran Kapaj, me motivacion: "Nismëtar në krijimin e shoqatës dhe mbështetës i gjithanshëm në gjirin e saj"
3. Fran Preçi, me motivacion: "Nismëtar në krijimin e shoqatës dhe mbështetës i gjithanshëm në gjirin e saj"
4. Ndue Vata, me motivacion: "Nismëtar në krijimin e shoqatës dhe mbështetës i gjithanshëm në gjirin e saj"
5. Martin Arra, me motivacion: "Nismëtar në krijimin e shoqatës dhe mbështetës i gjithanshëm në gjirin e saj"
6. Zef Nika, me motivacion: "Nismëtar në krijimin e shoqatës dhe mbështetës në realizimin e misionit të saj"
7. Luigj Mila, me motivacion: "Intelektual dhe koordinator i zellshëm i veprim-

tarive dhe ndikues i pa ndalur në shtrirjen dhe bashkëpunimin e realizimit të misionit të shoqatës"

8. Zef Bari, me motivacion: "Veprimtar i shkëlqyer i shoqatës për degën e Tiranës; burimor i fjalës së mençur; organizator e vlerë potenciale"
9. Aleks Dushi, me motivacion: "Organizator dhe promovues i veprimtarive të shoqatës në realizimin e misionit të saj; intelektual që prodhon risi bashkëkohore"
10. Prof. dr. Lek Sokoli, me motivacion: "Vlerë intelektuale nacionale, që i bënë ndere shoqatës sonë; shëmbëlltore e vlerave më të larta njerëzore"
11. Prof. dr. Vuksan Kola, me motivacion: "Promovues i përhershëm i shoqatës në realizimin e misionit të saj; vlerë intelektuale e pazëvendësueshme në gjirin e shoqatës; dimension i vërtetë i vlerave palcore dukagjinase"
12. Gjovalin Çuni, me motivacion: "Përkrahës i pakursyer i shoqatës sonë; ndihmesa e tij ka ndikuar fuqishëm në publikimin e vlerave dhe realizimin e misionit të saj"
13. Alfred Hanxhari, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm në veprimtaritë dhe në realizimin e misionit të shoqatës"
14. Shoqërisë kulturore-artistike "TREVA", me motivacion: "Mirnjohje për punën e tyre në krijimin, interpretimin dhe trashigimin e muzikës folklorike të zonës së Dukagjinit"
15. Nik Pali, pas vdekjes

10 VJETORI I SHOQATËS

1. Kompania e sigurimeve "SIGMA"-dega Shkodër, me motivacion: "Mbështetëse e vazhdueshme e botimit të gazetës "Dukagjini"
2. Ndue Mici, me motivacion: "Aktiv dhe mbështetës i përhershëm i shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
3. Prek Kosturi, me motivacion: "Aktiv i përhershëm gjatë veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
4. Gjergj Çuni, me motivacion: "Aktiv i përhershëm gjatë veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
5. Arben Gjuraq, me motivacion: "Shembull i intelektualit dhe drejtuesit bashkëkohor, që ruan vlerat e vendlindjes së tij, Dukagjinit"
6. Sokol Cubi, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
7. Dede Marashi, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
8. Fran Molla, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
9. Roza Pjetri, me motivacion: "Mbështetëse aktiv e përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
10. Syka Çarku, me motivacion: "Mbështetëse aktiv e përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
11. Marash Kola, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"
12. Eduard Çiurçija, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
13. Arjeta Ferlushkaj, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
14. Suela Ndoja, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
15. Bal Vuksani, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
16. Mark Kulla, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
17. Hil Kodra, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
18. Dede Zhivani, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
19. Mark Zhuri, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
20. Gjergj Vocaj, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
21. Pllumb Shqau, me motivacion: "Mbështetës aktiv i përhershëm të veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
22. Gjovalin Kodra, me motivacion: "Aktiv i përhershëm në realizimin e veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
23. Voc Deda, me motivacion: "Aktiv i përhershëm në realizimin e veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
24. Gjon Fierza, me motivacion: "Aktiv i përhershëm në realizimin e veprimtarive të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në realizimin e misionit të saj"
25. Pal Gjolaq, me motivacion: "Mbështetës financiar i realizimit të veprimtarive të shoqatës në këto 10 vite, në realizimin e misionit të saj"

Legjenda e Rozafates në variantin e Dukagjinit

Agron Luka

Studiuesi kolos Marin Sirdani (mjerisht ende i pavlerësuar në vendin e merituar, nga Këshilli Bashkiak dhe Bashkia Shkodër!), duke iu kundërvënë direkt ish kryeministrit serb Vladan Xhorxheviç dhe studiuesve folkloristë serbë, në vitin 1930, botoi studimin themelor "Legjenda e kshthjellit Rozafa". ("Hylli i Dritës", Nr. 10, 1930, f 541-560)

Teza kryesore e argumentuar nga Sirdani mbronte mendimin se shtresa e lartë feudale dhe disa qarqe klerikale sl-lavojugore e kishin kopjuar dhe përshtatur legjendën vendase Albane me flijim-murim të ndërtimit të kështjellës Rozafa të Shkodrës. Simbas Sirdanit në bazën e legjendës shkodrane qëndronte qysh nga antikiteti, një fenomen stalaktit, një piklim i qumështit gëlqeror mbasi i gjith ai formacion asht shkamb gëlqeror. Sirdani kishte mbledhur rreth dhjetë variante në kangë të legjendës.

Ne kemi në proces botimi një libër të veçantë mbi këtë temë. Nga variantet ne po ribotojmë variantin e Dukagjinit.



Terrakotë e sapozbuluar "Nusja shkodrane Fatia e flijuar ngurrosur/muruar" e shekullit VI-VII p.e.r.

LEGJENDA E ROZAFATIT

fotokopjim nga origjinali

LEGJENDA E KSHTHJELLIT «ROZAFAT»

Njai i vogli besen e ka mbajtë:
Kurë ka falë Zoti sabahin,
Mirë më janë veshë e mirë më janë mathë,
Kanë marrë rrugën n' ustallarë.

Kurë ka ardhë koha mo cilë
Ká qitë vjehrra e ká thánë:
« Zot, kú jé, mori reja e parë,
« Me çue buken n' ustallarë! »
« Jam e ligë e më dhambin gjit. »
« Zot, kú jé, o reja e dytë,
« Me çue buken n' ustallarë! »
« Jam e ligë e po më dhemb kryet. »
« Zot, kú jé, o reja e vogël,
« Me çue buken n' ustallarë! »
« Sa t' a lajë e të lidhi djalin. »
« Laje, e lidhe e shtjere në djep
« Se e perkund - o gjyahja e vet. »
« Paq, nafakë, o reja e vogël,
« Sot po e bán kalën në Shkodër! »

U nis nusja për me shkue
Bukë puntorve për me u çue.
Tuj u njitë për at kalá
Lot për faqe janë tuj rá:
« Lamtumirë shoqe e kojahi
« Lamtumirë shti e gjini,
« Lamtumirë, o rojt e mi,
« Lamtumirë, o djali i em,
« Kurr má nána në prëhen a' të vën. »

Të puntorët kurë ká shkue:
« Puna e mbarë, ja ustallarë! »
« Të mbarë paq, o vashë e bardhë! »

Tre jetina nana i ká pasë,
Ka'izet vjog m' i ká bá,
M' jan ká márrë trí nuse të mira.
Na kanë nisun një kalá,
Na k' n shtij tridhetë ustallarë:
K' deshtë Zoti e s' jan k' mbajtë.
Për gjith ditë kalán po e punojn
Për gjith natë kalaja po rrenohet.
Sa marak djelmt ishin bá!
Ték i dijsmi kurë kan shkue;
Kanë qitë të dijsmit e i kanë thánë:
« Na kemë nis - o një kalá
« Për gjith ditë kalán, e punojmë
« Për gjith natë kalaja po rrendohet »
Ka qitë i dijsmi e u ká thánë:
« Nji rob në kalá me há kurban,
« Njatsherë kalaja u foroon. »

Rán vllaznit te foljeta
Ishin lidhun besa - besa:
« Kush të na biju né cilen nésër
« Ne kalá na do t' a qesim. »
Dy má të mdhejt beset kau dalë

« Çë ká em zot qi á' lidhne? »
« A' lidhne se ka bjerë unazen. »
« Shndosh se unaza gjén në treg! »
« E zeza ditë kenka kanë,
« Në murë të kalás me të há kurban. »
« Kurkund gajle mos t' a kini,
« Veq të më báni një arkë guri,
« E të na shifni themel muri.
« Kurë të më futni në mur të kalás
« Gjin e djathë m' a leni jashtë;
« E kurë të mbushet e treta ditë
« Më bini Mirin me pí gjit.
« Gjin i em u nguroftë,
« E kalaja u foreoftë,
« Djali i em e gozftë
« U báftë kraj e luftoftë.
« Për njatë ditë qi djali e lshoftë
« Daltë Turku e e zaptoftë:
« Bift ferra e e mbloftë
« Gjofti rreftja e e shpartalloftë! »

(Dukagjin.)

P. MARIN SIRDANI, O. F. M.

Shoqata "Dukagjini", në Miçigan, promovuese e vlerave të traditës

"SHEMBULLI I PARË DHE POZITIV QË NJË SHOQATË DINË TË RESPEKTOJ NJËRZIT QË PUNOJNË DHE KRYESORE TË RESPEKTOJNE NJËRZIT E VET" "NDUE FTONI, NDERI I 100 VJETORIT"

Shoqata "Dukagjini" drejt programeve dhe nismave në fushën e kulturës për të promovuar tek mërgimtarët dhe gjeneratat e reja në mërgim vlerat e traditës së krahinës së tyre. Kohet e fundit kjo shoqate ka zhvilluar aktivitete të ndryshme edhe për përkujtimin i veprës së bashkatdhetarit të tyre nga Dukagjini, dom Prek Ndrevasajt.

Kryetari i kësaj shoqate, Nikolin Shyti pohon se, kryesia dhe anëtarët e saj, si të një familje janë të përkushtuar dhe të angazhuar seriozisht që aktivitetet të jene në vazhdimësi, për tema të veçanta, për ti dhënë një konceptim të ri çdo ngjarje kulturore dhe historike. Bashkëpunimin me shoqatën "Atdhetare-Dukagjini" në Shkodër e kemi në nivelin më të mire dhe së bashku bëjmë koordinimin e aktiviteteve.

Me rastin e festes së Pavarësisë së Amerikës, Shoqata "Dukagjini" organizoi në "The Imerial House" një mbrëmje kulturore dhe nderimi për tre nga eksponentët e kësaj shoqate. Për, **Pllumb Kullen**, i cili për disa vite ka drejtuar shoqatën me cilësinë e sekretarit të saj, dhe me profesionalizëm e ka drejtuar atë.

Për, **Ndrek Gurin**, poet dhe monografisti i figurës së Dom Prekes i jepet titulli "**Kryetar nderi i shoqatës Dukagjini**"

Për, **Ndue Ftonit**, biznesmen dhe humanist i jepet titulli "**Nderi i 100 vjetorit të Pavarësisë**" Ai ka kontribuar me dinjitet në fushën e kulturës dhe humanizmit njerëzor si në vendlindje dhe në diasporë. Spikat mundësori financiar i gazetës "Dukagjini", i Ansambllit folklorik "Trevë" të zonës së Dukagjinit, i cili ka arritur disa suksese të larta në konkurrimet nacionale. Ndue Ftoni mbështet aktivitetet kulturore dhe nacionale



të Institucioneve fetare dhe disa njerëzve, që kane pasur nevoja shëndetësore dhe ndërhyrje kirurgjikale. Ky konsull nderi i humanizmit e ka plotësisht te merituar këtë vlerësim, sepse siç tha ai, kur të nderon i yti, të nderon e gjithë shoqëria.

I nderuari **Ded Beleshi**, beri një kapërcim në harkuan plot emocion e vlerësim të figurës se Dom Prekes si gurthemeli i qendrës fetare "Zonja Pajtores", por edhe si një prijës që u kujdes për më shume se 14 mije emigrante të strehoheshin në Amerike, dhe deri tek **Ndue Ftoni**, që po manifeston vlerat më të fisshme të familjes dhe krahinës plot heroizëm të Dukagjinit. Beleshi e cilësoi mikun e tij Ftoni, si një shqiptar me zemër të madhe dhe bujare.

Profesor Prek Sokoliti, iu dha titulli "**Nderi i shoqatës Dukagjini**". Për aktivitetin dhe portretin e profesor Prek Sokoliti foli me një gjuhë të pastër e plot vlerësim Gjsh Gjergji

Në takimin e ditës së shtune, kishin ardhur të nderonin shoqatën "Dukagjini" edhe nga Neë-Yorku e Ohaio, në mes të cilëve edhe biznesmeni i njohur Satko Satka

Takimin e përshëndeten Adem Meta, Rrok Dedvukaj, Ded Toka, Ndue Grabanica, Prel Marku, Lulash Palushaj, këngëtar Fran Gjoka, i cili njoftoi se është themeluar shoqata "Puka"

Programit artistik i dhanë gjallëri këngëtarët Prel Marku, Ndue Buci e Gjergj Dushaj. Ishte një takim i bukur, ku të gjithë mbeten të kënaqur...

Zef PERGEGA, marre nga revista Online "Endërrat Shqiptare" 26 nëntor 2004, e datës 7 qershor 2013

Bukuria dukagjinase nder breza

VAJZAT E REJA DUKAGJINASE "VJEDJHIN" NË ARKAT E GJYSHEVE



Silvana Arrinaj, ajo që ideoi dhe realizoi prezantimin e bukurise dukagjinase nder breza



REDAKSIA
 Kryeredaktor: Lazër Kodra
 Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri,
 Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
 Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja